



Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Qendra “The Youth of Ura”

Adresa: Lagjia 18 Tetori, rruga Dimal, Ndërtesa 15/1, Ura Vajguore, Shqipëri

E-mail: beratcycle22@gmail.com

Afati i dorëzimit të ofertës: 12/08/2026

Qendra “The Youth of Ura” po zbaton projektin “*Rijetëzimi i Tregut të Gjellbër të Beratit*” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 3 (ReLOaD3), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në kuadër të zbatimit të projektit, organizata kërkon të kontraktojë një ekspert për përgatitjen e Planit të Biznesit, Planit të Marketingut dhe Rregullores së funksionimit të Tregut të Gjellbër. Shërbimi synon të mbështesë zhvillimin e Tregut të Gjellbër përmes analizimit të kostove dhe shpenzimeve, hartimit të një Plani Biznesi për optimizimin e funksionimit të tregut, përgatitjes së një Plani Marketingu për promovimin e tij dhe produkteve bujqësore, si dhe hartimit të Rregullores së funksionimit të Tregut të Gjellbër.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 12/08/2026, në adresën e e-mailit: beratcycle22@gmail.com ose në adresën postare Lagjia 18 Tetori, rruga Dimal, Ndërtesa 15/1, Ura Vajguore, Shqipëri.

Tipologjia e aplikantit

- Individ;
- Person fizik i regjistruar me NIPT;
- Person juridik/subjekt tregtar ose OJF me aktivitet dhe/ose përvojë në zhvillimin rural, ekonomi bujqësore, agrobiznes, planifikim biznesi, marketing, zhvillim të sipërmarrjes ose fusha të ngjashme.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Qendra “The Youth of Ura” do të zhvillojë procedurën e prokurimit për shërbimin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit	Njësi	Sasia	Çmimi/njësi PA TVSH	Çmimi/njësi si Me TVSH	Çmimi total (me TVSH)
----	-----------------------------------	-------	-------	------------------------	------------------------------	--------------------------



1	Shërbim ekspertize për analizën e kostove dhe shpenzimeve, hartimin e Planit të Biznesit, Planit të Marketingut dhe Rregullores së funksionimit të Tregut të Gjellbër.	Ditë	20			
---	--	------	----	--	--	--

Specifikime të përgjithshme teknike:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbimet në përputhje me objektivat e projektit "Rijetëzimi i Tregut të Gjellbër të Beratit", duke realizuar analizën e kostove dhe shpenzimeve të funksionimit të Tregut të Gjellbër, hartimin e Planit të Biznesit, Planit të Marketingut dhe Rregullores së funksionimit të Tregut të Gjellbër, në konsultim me fermerët dhe Bashkinë Berat.

Shërbimi do të realizohet gjatë një periudhe prej 20 ditësh pune dhe do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

1. Hartimin e metodologjisë së punës, planit të veprimit dhe strukturës së dokumenteve të ekspertizës, në konsultim me Autoritetin Kontraktor (1 ditë pune);
2. Analizimin e funksionimit aktual të Tregut të Gjellbër, përfshirë identifikimin e kostove, shpenzimeve, potencialit ekonomik, sfidave dhe mundësive për optimizimin e menaxhimit dhe zhvillimit të tij (4 ditë pune);
3. Hartimin e Planit të Biznesit për Tregun e Gjellbër të Beratit, duke përfshirë analizën ekonomike, modelin e funksionimit, propozimet për optimizimin e menaxhimit, shfrytëzimin e hapësirave, përfshirjen e fermerëve dhe rekomandimet për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut. (6 ditë pune);
4. Hartimin e Planit të Marketingut për promovimin e Tregut të Gjellbër dhe produkteve të fermerëve, duke përfshirë konsultime me fermerët dhe Bashkinë Berat për identifikimin e prioriteteve dhe finalizimin e dokumentit. (3 ditë pune);
5. Hartimin e Rregullores së funksionimit të Tregut të Gjellbër, duke përfshirë procesin e konsultimit me fermerët dhe Bashkinë Berat për reflektimin e komenteve dhe finalizimin e dokumentit (4 ditë pune);
6. Përgatitjen dhe dorëzimin e raportit përfundimtar të ekspertizës, duke përfshirë rekomandimet dhe produktet finale të hartimit (2 ditë pune).

Operatori ekonomik duhet të sigurojë të paktën një ekspert që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në ekonomi, agrobiznes, administrim biznesi, marketing, zhvillim rural, bujqësi ose një fushë tjetër të ngjashme.
- Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale në fushën e agrobiznesit, zhvillimit të biznesit, zhvillimit rural ose ofrimit të ekspertizës për sektorin bujqësor.



- Përvojë e dëshmuar në hartimin e planeve të biznesit, planeve të marketingut, analizave ekonomike ose dokumenteve strategjike për zhvillimin e bizneseve, tregjeve ose sektorit bujqësor.
- Përvojë në bashkëpunimin me fermerë, organizata të fermerëve, institucione publike ose aktorë të tjerë të zhvillimit rural përbën avantazh.
- Njohuri të mira mbi zhvillimin e agrobiznesit, marketingun e produkteve bujqësore, zinxhirët e vlerës dhe funksionimin e tregjeve bujqësore.
- Aftësi të mira analitike, në hartimin e dokumenteve teknike dhe strategjike, si dhe në lehtësimin e proceseve të konsultimit me aktorët lokalë.

Kushte të përgjithshme:

1. Në rast se ofertuesi është subjekt juridik, ai duhet të jetë i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushtrimin e aktivitetit përkatës. Individët mund të aplikojnë gjithashtu në këtë procedurë.
2. Preferohen individë ose subjekte me aktivitet në territorin e bashkisë Berat.
3. Oferta financiare duhet të jetë përfshirëse e të gjitha kostove që lidhen me ofrimin e shërbimit.
4. Oferta duhet të jetë në Lekë (ALL) dhe të përfshijë të gjitha detyrimet sipas statusit tatimor të ofertuesit. Në rast se ofertuesi është i regjistruar për TVSH, oferta duhet ta përfshijë TVSH-në dhe ta paraqesë atë të detajuar. Për individët, oferta duhet të përfshijë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë tatimin në burim (15%).
5. Dorëzimi i ofertës do të bëhet nëpërmjet email në adresën e organizatës beratcycle22@gmail.com brenda datës 12/08/2026, ose në adresën postare Lagjia 18 Tetori, rruga Dimal, Ndërtesa 15/1, Ura Vajguore, Shqipëri.

Nuk pranohen ofertat dorazi.

6. Paga e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu, krahas ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe me TVSH të identifikuar në mënyrë të veçantë, duhet të paraqiten edhe dokumentet e mëposhtme:

- Për personat juridikë/personat fizikë me NIPT: Ekstrakt QKB (jo më i vjetër se 3 muaj nga data e dorëzimit të ofertës);
- Fotokopje e kartës ID/pasaportës
- Oferta financiare;
- CV e ekspertit të propozuar. Në rast se ofertuesi është person juridik, duhet të paraqitet edhe një profil i shkurtër i institucionit.
- Diplomë universitare ose dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimin profesional të ekspertit;



- Dokumentacion që dëshmon përvojën në realizimin e shërbimeve të ngjashme ose kontaktet e referencave po për shërbime të ngjashme.

Vetëm operatori ekonomik që paraqet ofertën ekonomikisht më të favorshme dhe që plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në këtë Ftesë për Ofertë do të njoftohet dhe do të ftohet për nënshkrimin e kontratës.